

-- To Whom It may concern:

I. As a EU citizen, per law "Right to be Forgotten" ruling ((C-131/12), I am requesting that my personal information (my first/last name) and the inaccurate information to be removed as soon as possible. This case is still in court, and you are innocent until proven guilty.

II. If in deed my request is not honored and the link/s, and any further links that contain any of my information's is not removed, you can be held in contempt of breaching of law ruling C-131/12, and subject to a law suite against your online or print magazine.

III. Since the case is still active in the court of Prishtina (Kosovo), therefore all article published online or on any prints needs to be removed immediately.

I kindly request for the removal of the link below, and I also have included two out of many references in case you need to refer to the ruling on online publishing's.

<http://kallxo.com/deshmitari-tregon-si-ia-dha-te-akuzuarit-dokumentet-per-vize/>

For you reference:

<http://www.nytimes.com/2014/05/14/technology/google-should-erase-web-links-to-some-personal-data-europes-highest-court-says.html? r=0>

[http://ec.europa.eu/justice/data-protection/files/factsheets/factsheet\\_data\\_protection\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/justice/data-protection/files/factsheets/factsheet_data_protection_en.pdf)

This request is being done on behalf of mentioned defendant and all communication it needs to be in writing and per e-mail [vivalavida\\_07@yahoo.com](mailto:vivalavida_07@yahoo.com).

---

I nderuar,

Kërkesa juaj për tërheqje/mbulim të emrit të të akuzuarit Premton Harxhi konsiderojmë se është kërkesë e pabazuar në ligjet e aplikueshme vendore, të cilat janë në harmoni të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ndërsa kjo e fundit siç dihet është në harmoni të plotë edhe me ligjet ndërkombëtare.

Redaksia e KALLXO.com konsideron se i përmenduri Harxhi, kërkesën për anonimitet ka mundur ta bëjë qysh në fazën fillestare të procesit gjyqësor ndaj tij. I pandehuri në cilëndo fazë të procedurës penale që zhvillohet ndaj tij, mund t'i paraqesë gjyqtarit kompetent kërkesë me shkrim për masën mbrojtëse ose urdhrin për anonimitet. Të paktën ne nuk jemi në dijeni që i akuzuari në fjalë ka bërë një kërkesë të tillë, apo që gjykata të ketë lëshuar urdhër-mbrojtjeje për anonimitet ndaj tij (nëse keni prova në këtë drejtim për të cilat ne nuk jemi në dijeni, ju lutem na e provoni të kundërtën).

Bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, trupit gjykues me aktvendim me shkrim i lejohet të përjashtojë publikun. Në raste të tilla KALLXO.com çdo herë është treguar i kujdesshëm dhe nuk ka raportuar të thënat nga seancat e mbyllura për publikun, ndërsa

rasti për të cilin na referoheni ju nuk ka të bëjë me raportim nga seanca e mbyllur gjyqësore, andaj në këtë drejtim KALLXO.com ka raportuar në përputhje të plotë me Kodin e Mediave të Shkruara të Kosovës, saktësisht me **Kapitullin II- Raportimi i së Vërtetës dhe Kapitullin V- Personat e Akuzuar për Vepra Penale**.

Artikulli të cilit i referoheni ju, në KALLXO.com është raportuar më datë 30.10.2014 dhe ka të bëjë me akuzat e ngritura nga Prokuroria e Shtetit për veprat penale të kontrabandimit me migrantë, si dhe armëmbajtjes pa leje. Marrë parasysh peshën dhe dënueshmërinë e lartë të këtyre veprave penale, KALLXO.com konsideron se është në interes të publikut që të informohet lidhur me këtë proces gjyqësor. Nëse keni ndonjë vërejtje konkrete sa i përket raportimit të drejtë dhe pasaktësisë në të dhënat që janë prezantuar në këtë artikull, ju lutem na njoftoni.

Për më tepër, ky rast është ende në proces gjyqësor dhe gjykata ende nuk ka marrë aktgjykim përfundimtar. Ne jemi në dijeni që është ndërruar kryetari i trupit gjykues dhe është në pritje që lëndën ta marrë një gjyqtar tjetër. Sapo të ndodhë kjo dhe të caktohet seanca gjyqësore, KALLXO.com në përputhje me rregullat procedurale gjyqësore dhe Kodin Etik të Gazetarisë, me saktësi do të raportojë për gjithë procesin gjyqësor deri në plotfuqishmërinë e verdiktit final.

Në bazë të nenin 103 dhe 104 të Kodit Penal të Kosovës, ju keni të drejtë të kërkontë rehabilitim ligjor dhe gjyqësor, e drejtë kjo e cila rrjedh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe varësisht nga dënimi rrjedhin edhe afatet kohore brenda të cilave dënimi mund tëshlyhet nga evidencat e gjykatës, mirëpo kjo dispozitë nuk vlen me automatizëm edhe për mediat, ngase diçka që nuk është e ndaluar, me ligj konsiderohet si e lejuar.

Përfundimisht, redaksia e KALLXO.com konsideron që artikulli me titull “Dëshmitari Tregon Si ia Dha të Akuzuarit Dokumentet për Vizë” me linkun <http://kallxo.com/deshmitari-tregon-si-ia-dha-te-akuzuarit-dokumentet-per-vize/> do të vazhdojë të jetë i qasshëm për publikun. Nëse ju edhe më tutje insistoni që ky artikull të largohet, atëherë ne ju rekomandojmë që t’i drejtoheni gjykatës dhe nëse gjykata vendosë me masë të përkohshme që artikulli në fjalë të largohet, ne do të jemi të gatshëm të bashkëpunojmë dhe të respektojmë në plotëni vendimet gjyqësore.

Faleminderit:  
KALLXO.COM